



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2019:233457

Datë: 17.04.2024

Numri i dokumentit: 05585591

C.nr. 1047/23

Gjykata Themelore Prizren - dega Suharekë, gjyqtari Robert Tunaj me sek. Juridike F. Kabashi, në kontestin e paditësit KEK në P, të cilin e përfaqëson i autorizuari J. M, kundër të paditurit M. V nga fsh. S, të cilin e perf. av. R. H nga R, për shkak të borxhit, pas përfundimit të seancës kryesore, të dt. 08.04.2024, në prezencën e palëve, me datën 17.04.2024, mori dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET në tërësi e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit K. E e K - KEK Sh.a në P.

Detyrohet paditësi që të paditurit ti paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 705 € në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësi KEK Sh.a në P, në këtë gjykatë ka inicuar procedurën e përmbarimit në bazë të dokumentit te besueshëm me dt. 05.05.2009. Për shkak të kundërshtimit procedura kishte kaluar nga përmbarimi në procedura të kontestit sipas padisë. Kjo gjykatë me aktgjykimin C.nr. 416/13 ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit me aktgjykim për shkak te mos bindjes. Aktgjykimi C.nr. 416/13 është prishur dhe çështja është kthyer ne rivendosje me Aktvendimin e Gjykatës se Apelit AC.nr. 1418/15 të dt. 12.09.2019.

Kjo gjykatë me aktgjykimin C.nr. 544/19 ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit me dt. 28.12.2020. Ky aktgjykim përsëri priset me Aktvendimin e Gjykatës se Apelit AC.nr. 650/2021 dhe çështja kthehet në rivendosje.

Kjo gjykata pas kthimit të çështjes në rivendosje ka kërkuar nga paditësi të bëjë precizimin e kërkesëpadisë në përputhje me vërejtjet dhe sugjerimet e Gjykatës së Apelit me aktvendimin procedural të dt. 30.01.2024.

Paditësi me parashtrësën e dt. 01.02.2024 ka bërë precizimin e kërkesëpadisë e sipas të cilit tani kërkesëpadia e paditësit ka të bëjë me borxhin prej 9217.60 €, duke ndryshuar kështu kërkesën fillestare që ishte 3070,58 €. Në seancë gjyqësore i autorizuari i paditësit ka ngelur pranë padisë dhe kërkesëpadisë së precizuar me kërkesë që gjykata ti administroi provat dhe të njëjtën ta aprovoi.

Ne fjalën përfundimtare i autorizuari i paditësit ka theksuar se nga provat e administruara është vërtetuar baza juridike e kërkesëpadisë e po ashtu nga mendimi i dhënë nga eksperti A. H, është vërtetuar edhe lartësia e borxhit, në shumë prej 9102,38 €, ka precizuar përsëri kërkesëpadinë me kërkesë që gjykata ta obligoi të paditurin që shumen prej 9102,38 € ta paguaj me kamat ligjore nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive si dhe të detyrohet i padituri me shpenzimet e procedurës në emër të taksës gjyqësore.

I autorizuari i paditësit ka kundërshtuar në tersi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si dhe precizimin e kërkesëpadisë me pretendimin se edhe me tutje nuk është precizuar si duhet kërkesëpadia pasi që nuk ka pasur kohë të definuar si dhe kur është krijuar borxhi, i padituri ka bere pagesat e borxhit por ne mënyrë paushallë, për qka edhe ka propozuar nxjerrjen e ekspertizës me ekspert të elektros. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se qysh në fazën e inicimit të procedurës përmbartimore jemi thirrur ne parregullsi dhe kemi kundërshtuar kërkesën për shkak të parashkrimit. Nga ekspertiza e ekspertit të elektros është provuar se edhe faturimi edhe pagesat të gjithë periudhës kohore të pretenduar kanë qenë paushalle, nuk janë referuar faturave dhe regjistrimit të energjisë në periudha mujore, ashtu siq është i obliguar me rregullore të ZRRE-së, me kërkesë që gjykata kërkesëpadinë ta refuzoi në tersi për shkak të parashkrimit në përputhje me dispozitat e nenit 357 të LMD –ligji i zbatueshëm në kohën e krijimit të detyrimit, ku është paraparë që kërkesat për borxhet nga amvisëria parashkruhen për një vit. Pasi që borxhi i pretenduar fillimisht përfshijnë periudhën prej 2002 deri 2009 e me pas sipas precizimit të kërkesëpadisë të dt. 01.02.2024 borxhi përfshijnë periudhën deri në vitin 2013. Ka kërkuar shpenzimet e procedurës të specifikuar për 3 seanca nga 135 € dhe për ekspertizë të elektros 300 €, gjithsejtë 705 €.

Gjykata në bazë të nenit 8 të LPK beri administrimin e provave të propozuara nga palët dhe atë faturën DPZ64306 të dt.03.03.2009, transakcionin e konsumatorit me shifër DPZ3436 të dt. 24.02.2020, ekspertizën e ekspertit të elektros A. H, të dt. 12.03.2024, ka dëgjuar në seancë gjyqësore ekspertin e elektros.

Pas vlerësimit të provave veç e veç dhe te ndërlidhura me njëra tjetrën gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Paditësi ka ushtruar propozim për ekzekutim me dt. 30.04.2009 mbi bazën e faturës DPT64306 si dokument i besueshëm për borxhin në shumë prej 3070,58 €.

Nga fatura e dates 03.3.2009 provohet fakti se vlera e borxhit te pretenduar si ne faturë ka qenë 4526,98 €. Nga transaksioni i konsumatorit gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi të paditurit në vazhdimësi i ka faturuar në shuma të ndryshme deri me dt. 21.03.2006 kur vlera e borxhit të faturuar kishte arritur shumen prej 4474,38 €. I padituri nuk kishte bere asnjë pagesë për periudhën paraprake për prej tri vite (2003-2005) .

Nga dt. 24.03.2006 i padituri ka kryer detyrimet në vazhdimësi duke bërë pagesa të ndryshme në shuma paushallë pa ju referuar faturave të caktuara deri në momentin e ushtrimit te propozimit për ekzekutim 24.03.2009 kur kishte bere pagesën e fundit prej 150 €.

Nga transaksioni i konsumatorit gjykata ka provuar faktin se gjatë gjithë periudhës faturimi nga ana e KEK-ut ka qenë paushallë te ky përfundim gjykata ka ardhur për faktin se faturimi mujor ka qenë dukshëm me i ulët sipas ekspertit në raport me energjinë e shpenzuar e po ashtu nga transaksioni i konsumatorit provohet se faturat mujore janë sjellur nga 20 € deri në 60 €, ndërsa fatura e datës 02.11.2005 është 2350,51 € apo fatura e dt. 10.11.2007 e cila është 1704,03 €. Ndërsa në anën tjetër gjykata po ashtu ka vërtetuar faktin se pagesat në emër te borxhit nga i padituri në vazhdimësi janë ekzekutuar ne mënyrë paushallë duke mos ju referuar faturave e qe pagesat sillen nga 150 € deri në 450 € .

Edhe nga eksperti i elektros është vërtetuar fakti se gjate gjithë periudhës kohore faturimi nuk ka qenë real dhe ne përputhje me kërkesat e ZRRE-s për faturim mbi bazën e energjisë se shpenzuar brenda një muaj. E po ashtu nga eksperti është konstatuar se pagesat janë bërë në mënyrë paushallë duke mos ju referuar faturave te caktuara. Eksperti ka konstatuar se faturimi nga KEK-u në kundërshtim me procedurat për leximin e njësorëve te aprovuar nga ZRRE-a është jo stimuluese për konsumatorët për pagesat e rregullta, duke vërë konsumatorët ne lajthitje me pagesat e pa paguara. Te ky konstatim eksperti ka ardhur mbi bazën e energjisë së shpenzuar për 11 vite e që ka rezultuar se nje mesatare mujore prej 2000kw dhe një shume prej 159,78 € mujore, ndërsa transaksioni i konsumatorit dëshmon se faturimi ka qenë shumë më i ulët nëpër muaj ndërsa ne anën tjetër ka pasur muaj qe faturimi ka shkuar deri ne lartësinë prej 2350 €. Se faturimi ka qene paushall dhe në kundërshtim me rregullat e ZRRE-së eksperti ka provuar edhe faktin se te konsumatori është regjistruar dhe

faturuar në emër të vërejtjes për shkyçje shuma të caktuara e që në të vërtetë një gjë e tillë nuk ka guxuar të ndodhë. Nga ekspertiza gjykata ka vërtetuar se e gjithë energjia e shpenzuar e konsumatorit dhe regjistruar nga KEK-u e e cila nuk është paguar për periudhën 12.10.2002 deri me dt. 09.05.2013 ka qenë në shumë prej 9102,38 €. Me deklarin në seancë të ekspertit gjykata ka vërtetuar se nga periudha Mars 2009 që ka qenë kërkesa fillestare për pagesën e borxhit deri me 24.05.2013 ngarkesa e konsumatorit ka qenë 9999,53 €, ndërsa brenda kësaj periudhe kohore konsumatori ka paguar shumën prej 5042€, diferenca në mes ngarkesës - faturimit dhe pagesës ka qenë 4957,53 €.

Fatura e dt. 03.03.2009 thekson se borxhi i përgjithshëm i të paditurit kap shumën prej 4526,98 €, ndërsa shuma mujore e faturuar ka qenë 266,77 €, në anën tjetër nga transaksioni i konsumatorit provohet fakti se pagesa e kësaj fature është bërë me dt. 24.03.2009 në shumë prej 150 €, që provon edhe një herë faktin se të gjitha transaksionet – pagesat janë paushallë dhe nuk mund të provohet koha dhe mënyra e krijimit të tyre.

E gjendur para kësaj situatë gjykata ka ardhur në përfundim se paditësi nuk ka mundur të provoi periudhën kohore kur është krijuar detyrimi duke mos mundur të precizoi kërkesëpadinë në përputhje me vërejtjet dhe sugjerimet e Gjykatës së Apelit.

Në mungesë të provuarit të kësaj rrethane gjykata gjen të bazuar pretendimin e të paditurit se kërkesëpadija e paditësit fillimisht sipas padisë bazë është parashkruar pasi detyrimi ishte krijuar në vitin 2002 deri 2006 ndërsa padia është ushtruar në vitin 2009 ,e kërkesat për shpenzimet e energjisë në amvisni përshkruhen për një vit, ndërsa sa i për këtë precizimit të kërkesëpadiës i cili ka ndodhur me dt. 01.02.2024 në shumë prej 9102,38 €, kjo kërkesë është parashtruar pas kalimit të afatit prej më shumë se 10 vitesh e që si e tillë edhe kjo kërkesë është e parashkruar.

Gjykata ka gjetur se borxhi i pretenduar në kërkesëpadi për periudhën kohore 12.10.2002 deri me datën 24.05.2013 është parashkruar e konform dispozitave të nenit 360 par.1 pika 1.1 të LMD-së ku është paraparë se këto kërkesa të paraqitura në kërkesëpadi parashkruhen për një vit. Sipas kësaj dispozite ligjore kreditori ka të drejtë të kërkojë përmbushjen e borxhit pas çdo muaji periodik ndaj debitorit çka do të thotë se edhe parashkrimi sipas kësaj dispozite ligjore duhet të llogaritet në mënyrë periodike mujore në formë të veçantë .

Në pamundësi të precizimit të borgjit mujor-periodik në mënyrë të veçantë kërkesëpadinë e refuzoj në tersi e duke pas për bazë nenin 322 par.1 dhe 2 të LPK-së mbi barrën e provave ,pasi që barra e provave bije mbi paditësin , e paditësi nuk ka mundur të provoj pretendimin e tij.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u mor në përputhje me nenin 252 par.1 të LPK-së

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKE
C.nr. 1047/23 të dt. 17.04.2024

Sek. Juridike
Fitnete Kabashi

Gj y q t a r i
Robert Tunaj

KESHILLE JURIDIKE :Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejte ankese në afat prej 15 dite pas marrjes se te njëjtit, Gjykatës se Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.